



Agjencia Kombëtare e
Kontrollit të Cannabis-it

BULETIN 01



BULETIN

JANAR - MARS 2026

PËRMBAJTJA

- 01 Fjalë hyrëse nga Drejtori i Përgjithshëm**

- 02 Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it në fokus**

- 03 *Cannabis*-i dhe sfidat e Kapitullit 24**

- 04 Takim ndërinstitutional mbi komentet për draftin e Kodit Penal**

- 05 Ecuria e akteve nënligjore**

- 06 Njihuni me stafin e Agjencisë**



FJALË HYRËSE NGA DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Anila Alliu

Drejtore e Përgjithshme

Të nderuar lexues,

Cannabis-i mjekësor është sot pjesë e një zhvillimi ndërkombëtar që lidhet jo vetëm me trajtimin dhe lehtësimin e simptomave të disa sëmundjeve, por edhe me kërkimin shkencor, industrinë farmaceutike, industrinë ushqimore dhe programet universitare që po zhvillohen në këtë fushë. Në shumë vende, kjo nuk trajtohet më si një temë tabu, por si një sektor që kërkon dije, standarde, rregulla të qarta dhe kontroll të fortë shtetëror. Për Shqipërinë, ky proces nuk nënkupton hapjen e një tregu të pakontrolluar dhe as normalizimin e përdorimit të *cannabis*-it jashtë qëllimeve të përcaktuara me ligj. Përkundrazi, qasja jonë është e qartë: të ndërtojmë një sistem kontrolli mbi një aktivitet të ndjeshëm, ku çdo hallkë të jetë e monitoruar, e gjurmueshme dhe në përputhje me ligjin. Kjo do të thotë më shumë siguri, më shumë transparencë dhe më pak hapësirë për abuzim, informalitet apo devijim nga aktiviteti i ligjshëm.

Në thelb, nuk po hapet një treg pa kontroll; po vendoset kontroll shtetëror mbi një sektor që kërkon përgjegjësi të lartë publike.

Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it është krijuar për të garantuar pikërisht këtë rol: mbikëqyrjen, kontrollin dhe parandalimin e çdo devijimi, në mbrojtje të interesit publik, sigurisë dhe integritetit institucional. Ky numër i parë i buletinit pasqyron punën e bërë gjatë muajve të parë të vitit 2026, përfshirë bashkëpunimin ndërinstitutional, përgatitjen e kuadrit rregullator, angazhimet në procesin e integritetit evropian dhe hapat drejt konsolidimit të një modeli funksional kontrolli. Besoj se transparenca, përgjegjësia institucionale dhe komunikimi i hapur me qytetarët janë thelbësore për ndërtimin e besimit publik në këtë proces. Dëshiroj të falënderoj stafin e Agjencisë, institucionet bashkëpunuese dhe partnerët kombëtarë e ndërkombëtarë për mbështetjen dhe kontributin e tyre.

Me respekt,
Anila Alliu



Drejtore i Përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e
Kontrollit të *Cannabis*-it

ROLI DHE MISIONI I AGJENCISË

Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it (Agjencia) është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e proceseve që lidhen me kultivimin dhe përpunimin e bimës së cannabis-it, si dhe prodhimin e nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standardet ndërkombëtare. Veprimtaria e Agjencisë mbështetet në ligjin nr. 61/2023, i cili krijon bazën ligjore dhe institucionale për një sistem të kontrolluar, të sigurt dhe të gjurmueshëm.

Misioni i Agjencisë është të vendosë dhe të garantojë kontroll shtetëror mbi çdo aktivitet të lidhur me cannabis-in për qëllime mjekësore dhe industriale, duke siguruar që ky sektor të zhvillohet vetëm brenda ligjit, me transparencë, përgjegjësi dhe gjurmueshmëri të plotë. Për këtë qëllim, fokusi i veprimtarisë së Agjencisë është:

01 Zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator	02 Forcimi i mekanizmave të kontrollit dhe monitorimit
03 Garantimi i sigurisë, integritetit dhe gjurmueshmërisë së proceseve	04 Parandalimi i çdo devijimi nga aktiviteti i ligjshëm
05 Mbrojtja e interesit publik dhe e standardeve të sigurisë	06 Përafrimi me praktikat dhe standardet evropiane e ndërkombëtare

VEPRIMTARIA E AGJENCISË MBËSHTETET MBI DISA PARIME THEMELORE

BAZA LIGJORE

Ligji nr. 61/2023 "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale"

STRUKTURA

Institucion publik buxhetor në varësi të ministrit përgjegjës për shëndetësinë

SHTRIRJA E VEPRIMTARISË

Territori i Republikës së Shqipërisë

01 Bashkëpunim ndërinstitutional

Koordinimi me institucionet kombëtare dhe partnerët ndërkombëtarë për forcimin e kuadrit rregullator dhe zbatues.

02 Përafrim me standardet evropiane

Ndërtimi i praktikave dhe mekanizmave që reflektojnë kërkesat e integritetit evropian dhe standardet ndërkombëtare të kontrollit.

03 Transparencë

Procese të qarta, të dokumentuara dhe të kuptueshme për publikun dhe institucionet.

04 Gjurmueshmëri

Ndjekje e plotë e aktivitetit nga kultivimi deri te përpunimi, ruajtja, transporti dhe destinacioni final.

CANNABIS-I DHE SFIDAT E KAPITULLIT 24 | BRUKSEL 3-4 MARS 2026



Në datat 3-4 mars 2026, në Bruksel, u zhvillua mbledhja e 17-të e Nënkomitetit të Stabilizim-Asociimit, Bashkimi Evropian-Shqipëri për Kapitullin 24: "Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë", në të cilin Agjencia u përfaqësua nga Drejtori i Përgjithshëm, znj. Anila Alliu.

Në fokus të diskutimeve ishte bashkëpunimi në fushën e drogave, me vëmendje të veçantë te sekuestrimet, asgjësimi dhe zbatimi i masave ndaj shkeljeve që mund të lidhen me kultivimin e ligjshëm të bimës së *cannabis*-it.

Pjesëmarrja në këtë proces rikonfirmon angazhimin e Shqipërisë për të ndërtuar një model të kontrolluar, transparent dhe të besueshëm, në përputhje me kërkesat e integritetit evropian dhe me përgjegjësinë që kërkon një sektor i tillë i ndjeshëm.

[Lexo më shumë...](#)

TIRANË · 25 JANAR 2026

TAKIM NDËRINSTITUCIONAL MBI KOMENTET PËR DRAFTIN E KODIT PENAL

Më 25 janar 2026, në ambientet e Shkollës së Magjistraturës, u zhvillua një takim konsultativ mbi komentet dhe sugjerimet për draftin e Kodit Penal, me pjesëmarrjen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, institucioneve të varësisë, si edhe aktorëve të tjerë të përfshirë në proces.

Takimi shërbeu për të koordinuar qëndrimet ndërinstitucionale mbi çështje që prekin kuadrin penal dhe administrativ të sektorëve përkatës, përfshirë dispozitat me rëndësi për kontrollin e *cannabis*-it mjekësor dhe industrial.

Për Agjencinë, pjesëmarrja në këtë proces lidhet drejtpërdrejt me nevojën për të siguruar që çdo aktivitet i ligjshëm të jetë i mbrojtur nga keqpërdorimi, ndërsa çdo devijim të trajtohet qartë, me bazë ligjore dhe me mekanizma efektivë përgjegjësie.

[Lexo më shumë...](#)

JANAR – MARS 2026

ECURIA E AKTEVE NËNLIGJORE DHE BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2026, Agjencia u angazhua në diskutimin, koordinimin dhe finalizimin e katër projektvendimeve të Këshillit të Ministrave, në zbatim të ligjit nr. 61/2023.

Ky proces nuk ishte vetëm teknik, por një hap thelbësor për të vendosur rregulla të qarta mbi mënyrën se si do të funksionojë kontrolli shtetëror në sektor. Për këtë qëllim, Agjencia zhvilloi takime pune dhe komunikime të dedikuara me institucionet përgjegjëse, me synim qartësimin e roleve, shmangien e mbivendosjeve dhe garantimin e sigurisë së procesit.

Bashkëpunimi ndërinstitutional është një nga kushtet kryesore për ndërtimin e një modeli të besueshëm. Vetëm përmes rregullave të qarta, përgjegjësive të ndara dhe mekanizmave të koordinuar mund të sigurohet që sektori të zhvillohet brenda ligjit, me transparencë dhe me gjurmueshmëri të plotë.

6

TAKIME TË ZHVILLUARA

11

INSTITUCIONE
PJESËMARRËSE NË TAKIME

NJIHUNI ME STAFIN E AGJENCISË



Farmaciste, e diplomuar në Departamentin e Farmacisë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Si pjesë e ekipit të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it, ajo angazhohet në çështje që lidhen me rregullimin, mbikëqyrjen dhe standardet e cilësisë në sektorin e *cannabis*-it mjekësor.

Alesia Vasku

"Ajo që më ka tërhequr më shumë në fushën e cannabis-it mjekësor është kompleksiteti dhe dinamika e saj. Është një sektor ku shkenca, kuadri rregullator dhe interesi publik ndërthuren çdo ditë, duke krijuar mundësi për ndërtimin e proceseve dhe standardeve të qëndrueshme. Besoj se sa më shumë të mbështetemi në fakte dhe prova shkencore, aq më shumë mund të kontribuojmë në krijimin e një këndvështrimi më objektiv dhe të balancuar mbi këtë fushë."



**Agjencia Kombëtare e
Kontrollit të Cannabis-it**



www.nacc.gov.al



info@nacc.gov.al



Rruga "Ibrahim Rugova", 5,
Kati 13, 1001, Tiranë